



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

Nr. 434/5 Prot.

Tiranë, më 4/7/2013

**Lënda:** Rekomandim për kontrolluesin "Institucioni i Avokatit të Popullit"

**REKOMANDIM**

Nr. 10 datë 04/7 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Institucionit të Avokatit të Popullit

**KONSTATOVA**

Në datë 02/05/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, Institucioni i Avokatit të Popullit me objekt:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale prej kontrolluesit "Avokati i Popullit":**
- Verifikimi i qëllimit/qëllimeve të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, bazuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në lidhje me:
  - Kategoritë e të dhënave që përpunohen dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave;
  - Baza ligjore e përpunimit të këtyre të dhënave;
  - Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
  - Marrjen e pëlqimit të informuar;

- Kohën e ruajtjes së të dhënave personale që përpunohen;
- Të dhënat sensitive;
- Saktësinë dhe përditësimin e të dhënave personale që përpunohen;
- Përhapjen e të dhënave të mbledhura e të përpunuara, tek të tretët;
- Transferimin ndërkombëtar të këtyre të dhënave;
- Procesin e njoftimit dhe regjistrimit;
- Sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale që përpunohen.

Institucioni i Avokatit të Popullit si institucion i pavarur kushtetues mbështet punën e tij mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin organik nr. 8454 të datës 4/02/1999 i ndryshuar “Për Avokatin e Popullit”, ligjin nr. 8485 datë 12/05/1999 “Kodi i Procedurës Administrative”, akteve rregullative të nxjerra prej tij dhe gjithë legjislacionin shqiptar sipas fushave të veprimit në rast trajtimit të ankesave të ndryshme.

Parë në këndvështrimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe konkretisht sipas objektit të urdhërit të kontrollit administrativ, Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të funksionit të tij merr cilësinë e kontrolluesit publik, pasi sipas përkufizimit në ligj “*Kontrollues*” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj. Në këtë aspekt ky kontrollues gjatë trajtimit të ankesave të ndryshme të qytetarëve si subjekte të të dhënave personale, mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive të tyre.

Gjatë kontrollit administrativ u inspektua mbi kategoritë e subjekteve të të dhënave personale (*individ, person fizik/juridik që drejtohen me ankesë kontrolluesit, të punësuarit pranë kontrolluesit, si dhe të tretët me të cilët kontrolluesi hyn në marrëdhënie*).

Për këto kategori subjektesh të të dhënave personale u kontrollua ligjshmëria e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, verifikimi i qëllimit të mbledhjes përpunimit të të tyre, në respektim të kushteve dhe kritereve që parashikon ligji nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Konstatohet se kontrolluesi “Avokati i Popullit” për mbledhjen e të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale individë, *persona fizike/ juridike* ka hartuar formularë ankese tip në të cilin specifikohen të dhënat personale që kontrolluesi mbledh për këtë kategori subjektesh të të dhënave, të tilla si *emri, mbiemri, atësia, mosha, arsimi, cilësi të veçanta, adresa, shtetësia, gjinia, profesioni, nr. telefonit, e -maili*. Subjekti i të dhënave personale duhet të nënshkruajë formularin me emër mbiemër dhe firmë.

Në fundin e formularit tip citohet se; “*Në bazë të ligjit Nr.9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar Institucioni i Avokatit të Popullit ruan kofidencialitetin e të dhënave personale. Nënshkrimi nga ana juaj i këtij formulari, nënkupton dhënien e pëlqimit duke respektuar*

*kofidencialitetin. Asnjë e dhënë nuk publikohet apo komunikohet personave të tretë pa miratimin tuaj paraprak”.*

Për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale të punësuar kontrolluesi të dhënat personale të tyre i mbledh nëpërmjet dokumentacionit që ata dorëzojnë në krijimin e dosjeve të tyre personale në momentin e lidhjes së kontratave të punësimit.

Për kategorinë e subjekteve të të dhënave *persona të tretë*, në të cilën futen individë, persona fizikë/juridikë që hyjnë në marrëdhënie me kontrolluesin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, si dhe persona fizike e juridike që ofrojnë shërbime kontraktore etj.. kontrolluesi Avokati i Popullit mbledh dhe përpunon të dhëna personale të tyre, që lidhen vetëm me të dhënat e bëra publike në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit etj.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar konstatohet se kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet sistemit të videosurvejimit. Instalimi i sistemit të kamerave është bërë nga një firmë private me miratim të kontrolluesit përpara 4 vjetësh, por nuk disponohet një kontratë.

Kontrolluesi nuk disponon një skemë të plan-vendosjes së kamerave ku përcaktohen vendet dhe ambientet që monitorohen. Nga këqyrja e ambienteve që monitorohen me kamera rezulton se kamerat janë vendosur në korridore, hollin e pritjes, dhe në të dy anët e godinës me kënd pamjeje territorin ku parkohen makinat në perimetrin rrethuese brenda godinës. Kamerat janë model i pa-lëvizshëm me kënd fiks dhe model analog (jo IP-based të lidhura në rrjet).

Qëllimi primar i vendosjes së kamerave sipas kontrolluesit është siguria e ambienteve të kontrolluesit, por dhe monitorimi i disiplinës së punonjësve. Aksesin në këtë sistem e ka vetëm Sekretari i Përgjithshëm i kontrolluesit, në zyrën e të cilit është vendosur ekrani dhe sistemi monitorues. Sistemi i monitorimit nuk është i lidhur me rrjetet interneti. Afati i ruajtjes së regjistrimeve është 30- ditë, periudhë e kushtëzuar nga kapaciteti i hard-diskut të pajisjes regjistruese.

Nga kontrolli konstatohet se kontrolluesi nuk ka të shkruar rregulla për këtë lloj mbledhje dhe përpunimi të dhënash. Gjithashtu në ambientet e kontrolluesit nuk ka të vendosura tabela informuese për këtë lloj mbledhje dhe përpunimi të të dhënave personale.

Nga konstatimet e grupit të kontrollit për këtë lloj mbledhje dhe përpunimi të dhënash personale vlerësojmë se kontrolluesi Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka respektuar kushtet dhe kriteret e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, si dhe udhëzimin e veçantë nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *“Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*.

Mbledhja dhe përpunimi i dhënave personale dhe sensitive për gjithë kategoritë e subjekteve të të dhënave nga kontrolluesi “Avokati i Popullit” u konstatua se bëhet në rrugë manuale dhe në rrugë elektronike, kështu për

të dhënat personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave *ankues persona fizikë/juridikë*, për rastet e trajtimit të ankesave të tyre kontrolluesi ka të instaluar një sistem elektronik të emërtuar “Doc Live”

Sistemi elektronik Doculive Case Archive u bë objekt kontrollit administrativ, nga dokumentacioni që kontrolluesi ka për këtë sistem mundësimi i aksesit në të etj.. rezulton se mbledhja, përpunimi i të dhënave personale për subjektet e të dhënave personale që bëhen pjesë e këtij sistemi është konform kushteve dhe kritereve të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Për sistemin kontrolluesi ka dokumentacion dhe rregulla të shkruara, sistemi është i siguritë dhe kofidencial. Lidhur me sistemin elektronik vërehet se kontrolluesi nuk ka parashikuar në rregullore procedura për kohën e ruajtjes se të dhënave dhe asgjësimi të të dhënave personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të relacionit të kontrollit administrativ, procesverbalit të këtij kontrolli administrativ, provave të administruara vlerëson se përgjithësisht kontrolluesi Institucioni i „Avokatit të Popullit” gjatë ushtrimit të funksionit të tij, në aspektin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive, për gjithë kategoritë e subjekteve të të dhënave, trajtimin e tyre në rrugë manuale por dhe në rrugë elektronike, mban parasysht kushtet dhe kriteret e ligjit Nr.9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Kjo rezulton e shprehur në masat e marra nga kontrolluesi për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave personale në mënyrë të ligjshme, për qëllime specifike, përpunimi i të dhënave në përputhje me qëllimin , në mjaftueshmërinë e të dhënave, në masat e marra për sigurinë e të dhënave, kofidencialitetin e të dhënave personale, përhapjen e të dhënave, informimin dhe marrjen e pëlqimit të subjektit të të dhënave.

Por krahas kësaj nga kontrolli administrativ i zhvilluar u vrejtën dhe disa konstatime të cilat lidhen me;

- Mungesa e një rregullore të veçantë, apo një pakete rregullash të përfshirë në rregulloren institucionale, ku të përcaktohen qartë rregullat për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, kohën e ruajtjes, procedurat e asgjësimit të të dhënave personale, në rrugë manuale dhe elektronike, për subjektet e të dhënave personale, si kundër kërkohet në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, (neni 27dhe 28).
- Mungesa e rregullave të shkruara, lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet video-survejimit (regjistrim me kamera), mungesa e informimit për këtë lloj përpunimi sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 6, 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe udhëzimi të veçantë nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera.

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative,

### REKOMANDOJ

- Në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Institucioni i “Avokatit të Popullit”, të hartojë rregullore të veçantë lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale.
- Në zbatim të neneve 6, 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, udhëzimit të veçantë nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, kontrolluesi Institucioni i “Avokatit të Popullit”, të hartojë rregullore të shkruar, për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të video-surveimit (regjistrim me kamera), të behët informimi duke u vendosur tabelat informuese për këtë lloj përpunimi sipas standardit të miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Kontrolluesi Institucioni i “Avokatit të Popullit” mbas përmbushjes së këtyre rekomandimeve mbart detyrimin për të njoftuar Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

